



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 284/5 prot.

Tiranë, më 30.6.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 675, datë 16.6.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Balla
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 16.6.2023, është njoftuar vendimi nr. 675, datë 16.6.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Balla, Ndihmësligjor në Gjykatën e Lartë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 675, datë 16.6.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Balla, ka ushtruar funksionin e Ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë, nga data **.4.2014 deri në datën **.9.2017.
2. Rezulton se bazuar në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës dhe nenin 165/2 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Alfred Balla, bën pjesë në subjektet e rivlerësimit që i përkasin kategorisë së rivlerësimit *ex officio*.
3. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dorëzuar deklaratën e pasurisë në ILDKPKI, bazuar në nenin 31 të ligjit nr. 84/2016, deklaratën për kontrollin e figurës, në Drejtorinë e

Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe tri akte ligjore pranë ish-KLD-së. Për sa i përket kriterit të aftësisë profesionale, rezulton se z. Balla nuk ka marrë pjesë në provimin për rivlerësimin kalimtar *ex officio*, të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, në datat 7 dhe 8 maj 2018¹.

4. Megjithëse prej datës 18.2.2018, z. Alfred Balla ishte zgjedhur anëtar i Këshillit të Lartë i Prokurorisë, nga radhët e shoqërisë civile, dhe rezultonte të ishte njëkohësisht në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, subjekt i procesit të rivlerësimit kalimtar, Komisioni e organizoi shortin për caktimin e trupit gjykues në datën **12.12.2021**.

5. Pasi u njoftua në rrugë elektronike për fillimin e procedurave për shqyrtimin e akteve të procesit të rivlerësimit kalimtar përkatës, me *email*-in e datës **6.1.2022**, subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Balla, ka konfirmuar marrjen e *njoftimit*, dhe faktin që nuk ka asnjë konflikt me asnjë nga anëtarët e trupit gjykues. Në këtë *email*, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, referon se i është drejtuar Komisionit në vitin 2018, me kërkesën për ndërprerjen e kësaj procedure, kërkesë për të cilën referon se nuk ka marrë ende përgjigje. Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, pretendon: [...] *se një proces i tillë Vettingu nuk më duhet se nuk kam statusin e magjistratit si Ndihmësligjor në Gjykatën e Lartë [...]*.

5.1 Referuar interpretimit të tij për të mos iu nënshtuar procesit, subjekti i rivlerësimit, në kërkesën për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, të protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë ****6.2018**, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *duke pasur parasysh qëllimin e ligjit për rivlerësimin kalimtar, i cili ka si objekt kontrollin për gjyqtarët, prokurorët dhe këshilltarët ligjorë aktualisht në detyrë, në zbatim të neneve 179/b të Kushtetutës të Shqipërisë, 3/16 dhe 58 të ligjit nr. 84/2016 (dispozita të cilat përcaktojnë se cilat nga subjektet e rivlerësimit po kështu dhe tagrat e vendimmarrjes së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit) vlerësoj se, **unë nuk jam më subjekt i kontrollit sipas ligjit nr. 84/2016, ndaj procedura e rivlerësimit kalimtar (Vettingut) ndaj meje duhet të ndërpritet [...]**.*

5.2 Rezulton nga aktet, se subjekti i rivlerësimit, ndërkohë që me kërkesën datë ****6.2018**, i kërkonte Komisionit të ndërpritej procesi i rivlerësimit, nga ana tjetër, kishte kërkuar kontrollin gjyqësor të procedurës së ndjekur për lirim nga detyra e Ndihmësit ligjor të Gjykatës së Lartë, duke pretenduar pavlefshmërinë absolute të urdhrin të Kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe gëzimin e statusit të Ndihmësit ligjor pranë kësaj gjykate deri ditën e zgjedhjes anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Pasi me vendimin nr.***, datë ****3.2021**, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë vendosi shpalljen e moskompetencës, gjykimi vijoi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, së cilës subjekti i rivlerësimit i kërkoi të shprehej për kërkimet e padisë: [...] *(i) detyrimin e palës së paditur (Gjykata e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor), t'i njohë të drejtën e rikthimit të paditësit në pozicionin e Këshilltarit jomagjistrat në Gjykatën e Lartë, pas mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për shkak se kishte statusin e Këshilltarit/Ndihmësit ligjor, në momentin e emërimit në KLP; (ii) detyrimin e palës së paditur t'i shpërblejë paditësit dëmin nga ndërprerja e marrëdhënies së punës në vlerën e pagave, për periudhën datë ****9.2017** deri më datë ****12.2018**, për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punësimit nga organi jokompetent; (iii) detyrimin e palës së paditur të paguajë të gjitha shpenzimet procedurale gjyqësore [...]*.

¹ Referuar vërtetimit nr. *** prot., datë ****6.2018**, të Shkollës së Magjistraturës.

5.3 Po ashtu, subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Balla, rezulton se kishte paraqitur për shqyrtim edhe në KLGJ një kërkesë për deklarimin e pasjes/njohjes së statusit të Këshilltarit/Ndihmësit jo magjistrat pranë Gjykatës së Lartë, kërkesë që me vendimin nr. ***, datë **.12.2020, të KLGJ-së ishte pezulluar së shqyrtuari për shkak të padisë së ngritur nga ana e subjektit të rivlerësimit në juridiksionin gjyqësor.

5.4 Në një *email* të dytë, të datës **10.1.2022**, drejtuar trupit gjykues të Komisionit, pasi Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë kishte marrë dhe vendimin mbi kërkimet përkatëse, subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Balla, pasi depoziton disa akte mbi ecurinë e tij profesionale², kërkon ndërprerjen e procesit pa vendim përfundimtar, duke renditur, ndër të tjera, disa rrethana: [...] (i) *Jam emëruar ndihmës ligjor...në Gjykatën e Lartë, me urdhrin nr. **, datë **.04.2012, të Kryetarit të kësaj Gjykatë. Në momentin që isha në këtë detyrë, doli ligji për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve, i cili përfshinte dhe ndihmësit e këshilltarët ligjor në Gjykatën e Lartë. Kam bërë sipas ligjit, dorëzimin e deklaratës për Vetting pranë ILDKPKI-së, pranë DSIK-së dhe të tri akteve ligjore pranë ish-KLD-së; Kam punuar për gati 5 vjet në këtë pozicion dhe me përfundimin e mandatit të gjyqtarit, Kryetari i Gjykatës së Lartë, me urdhrin nr. ***, datë **.7.2017, ka vendosur “lirimin nga detyra”, pasi ka përfunduar afati i kontratës së punës. (ii) Momenti i largimit përfundimtar nga detyra në Gjykatën e Lartë është data ** shtator 2017, pasi bëra dhe dorëzimet e duhura të dosjeve sipas urdhrorit. Me hapjen e garës nga Avokati i Popullit, në datën 30.11.2017, kam aplikuar për pozicionin kushtetues të Anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si pjesë e Shoqërisë Civile. Me vendim të Kuvendit të Shqipërisë në datën 8.2.2018 jam zgjedhur nga Kuvendi anëtar i KLP-së, si pjesë e Shoqërisë Civile (KLP ka në përbërje 2 pedagogë, 2 avokat, 1 përfaqësues të shoqërisë civile dhe 6 prokurorë). Në datën 19.12.2018, KLP-ja u konstitua dhe unë jam anëtar i saj, tashmë me statusin e kryetarit të këtij organi, me mandat 5-vjeçar, deri në datën 18.12.2023. (iii) Duke menduar se u largova jashtë dëshirës sime nga detyra dhe procedura e Vettingut tim kishte përfunduar, në datën 22.6.2018, i jam drejtuar me shkresë KPK-së, ku kam kërkuar ndërprerjen e kësaj procedurë (pa vendim përfundimtar, pasi ka rënë objekti). Nuk kam marrë asnjë përgjigje për këtë procedurë të iniciuar nga ana ime; (iv) Pas tre vitesh nga largimi nga detyra për të testuar problemin juridik të ruajtjes apo jo të statusit juridik të Ndihmësit ligjor, duke parë një praktikë të KLGJ-së, vendosa të ndjek rrugën ligjore të gjyqit dhe drejtuar kërkesë KLGJ-së për statusin e pretenduar; (v) **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. *** (***)**, **datë **.7.2021³**, vendosi: “Pranimin e pjesëshëm të kërkesëpadisë; detyrimin e palës së paditur. Gjykata e Lartë që t’i paguajë paditësit dëmin nga ndërprerja e marrëdhënies së punës në masën e pagesës për periudhën **.09.2017- **.02.2018; rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të saj; shpenzimet gjyqësore në masën 1/2 i ngarkohen palës së paditur Gjykata e Lartë”. (vi) Për kërkesën paralele që bëra në KLGJ, me vendimin nr. ***, **datë **.12.2020**, ky organ ka vendosur; “Pezullimin e shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga z. Alfred Balla, për deklarimin e pasjes/njohjes së statusit të këshilltarit/ Ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë, për shkak se kërkesa është në shqyrtim pranë Gjykatës [...]”.*

² Subjekti i rivlerësimit z. Alfred Balla, ka depozituar në Komision në rrugë elektronike me *email* dokumentacionin e emërimit, lirimit nga detyra pranë Gjykatës së Lartë, si dhe dokumentacion provues ligjor në të cilin mbështet deklaratimet dhe shpjegimet e tij.

³ Subjekti i rivlerësimit, ka paraqitur kërkesë-padinë me datë **.9.2020.

5.5 Në vijim të këtij komunikimi të subjektit të rivlerësimit me Komisionin, vëzhguesi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM), me aktin nr. ***, datë ****6.2022**, (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë **.6.2022), bazuar nenin B, pika 3, të aneksit të Kushtetutës⁴, dhe nenin 49, pika 11, e ligjit nr. 84/2016⁵, i ka paraqitur Komisionit dokumentin *Opinion/Mendim*, duke parashtruar se: [...] *në lidhje me rrethanat konkrete që mbështesin këtë mendim, monitoruesi ndërkombëtar vlerëson se analiza e dokumenteve të administruara/disponueshme dhe analiza e ligjit të aplikueshëm, mbështesin konkluzionin se z. Alfred Balla, ka pasur në vazhdimësi statusin e subjektit të rivlerësimit dhe prandaj Komisioni duhet të vazhdojë procesin e tij të rivlerësimit [...]*.

5.6 Vëzhguesi ndërkombëtar, në përfundim të analizës të legjislacionit të zbatueshëm, jurisprudencës së Kolegjit, si dhe akteve në dosje, argumenton se: [...] *z. Alfred Balla është subjekt rivlerësimi dhe, si i tillë, duhet t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit. Për më tepër, statusi që z. Balla kishte në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, nuk është hequr apo zhdukur gjatë kohës dhe nuk është ndikuar nga fakti që z. Balla nuk ushtronte më detyrën e Ndihmësit ligjor jomagjistrat dhe u bë anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë [...]*.

6. Pas administrimit të këtij opinioni të vëzhguesit ndërkombëtar, trupi gjykues i Komisionit, me *email-in* e datës **9.11.2022**, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit, z. Balla, ndër të tjera, se [...] *Trupa gjykuese... mori në shqyrtim kërkesën tuaj për përfundimin e procesit tuaj të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar, dërguar me email e datës 10.1.2022. Kjo trupë gjykuese, pas shqyrtimit të kërkesës tuaj vendosi mospranimin e kërkesës tuaj dhe kryerjen e procesit të rivlerësimit për ju si një subjekt i ligjit nr. 84/2016. Arsyetimi i këtij vendimi do të bëhet bashkë me vendimin përfundimtar. Kundër këtij vendimi mund të ushtroni ankim së bashku me vendimin përfundimtar. Lutemi në vijim të procesit të rivlerësimit t'i përgjigjeni pyetësorit standard...brenda datës 23.11.2022 [...]*.

7. Me dërgimin e pyetësorit standard, Komisioni rezulton se në rastin konkret ka nisur kryerjen e procedurave që ndiqen me të gjithë subjektet e rivlerësimit gjatë zhvillimit të procesit. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, me *email-in* e datës **30.11.2022**, e ka kthyer të plotësuar pyetësorin standard, të dërguar nga ana e Komisionit.

8. Në këto rrethana, subjekti i rivlerësimit në vijim ka dërguar një tjetër *email*, atë të datës **12.12.2022**, dhe me anë të rrugës postare në datën **14.12.2022**⁶, duke kërkuar kësaj radhe, jo më ndërprerjen e procesit, por pezullimin e procedurës së rivlerësimit kalimtar të tij deri në përfundimin e procesit gjyqësor dhe daljen e gjykatës me një vendim të formës së prerë lidhur me çështjen e pasjes ose jo nga ana e tij të statusit të Këshilltarit të Gjykatës së Lartë.

9. Trupi gjykues, me *email-in* e datës **16.1.2023**, ndër të tjera, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit, se: [...] *pasi shqyrtoi kërkesat e subjektit të datës 12.12.2022 dhe 14.12.2022, ka*

⁴ Sipas së cilës, ndër të tjera [...] Vëzhguesi ndërkombëtar...b) paraqet gjetje dhe mendime mbi çështje që shqyrtohen nga Komisioni dhe nga Kolegji i Apelit [...].

⁵ Ku ndër të tjera, parashikohet se: [...]Një mendim me shkrim i dhënë nga vëzhguesit ndërkombëtarë konsiderohet një përfundim i dhënë për një rrethanë konkrete gjatë procesit të rivlerësimit ose që rezulton nga faktet në çështje të veçanta [...].

⁶ Bashkëlidhur subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar: (1) vendimin nr. ***, datë **.12.2020, të KLGJ-së, për shqyrtimin e kërkesës për pasje/njohje të statusit të Këshilltarit/Ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë, për shkak se kërkesa është në shqyrtim para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (2) Vërtetim i Gjykatës së Apelit Administrativ, datë **.12.2022, që çështja është regjistruar në datën **.10.2021, dhe i ka kaluar gjyqtarit ***.***; (3) Kopje e paraqitjes së kërkesës pranë Kuvendit, datë **.12.2022, për vënien në dispozicion të akteve, si dhe interpretim juridik të thelluar.

vendosur mospranimin e kërkesës për pezullimin e procedurës së rivlerësimit. Ju do të gjeni arsyetimin e këtij vendimi me vendimin përfundimtar [...].

10. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankim ndaj vendimit të Komisionit datë 16.1.2023, të komunikuar me *email*, nëpërmjet aktit të protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë ****1.2023**.

11. Në vijim të këtij ankimi të subjektit të rivlerësimit, vëzhguesi ndërkombëtar, bazuar nënin B, pika 3, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenin 49, pika 10 dhe 11, të ligjit nr. 84/2016, me shkresën nr. ** prot., datë ****1.2023** (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë ****1.2023**), ka depozituar në Komision aktin: *Gjetje⁷ dhe Opinion/Mendim*, duke konkluduar se: [...] *ankimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit Alfred Balla nuk është nga ato që ligji në fuqi i parashikon shprehimisht si të pranueshme në këtë fazë të procedimit. Prandaj ankimi duhet të refuzohet nga Komisioni, e cila rekomandohet të mos dërgojë dosjen në Kolegj për të shmangur vonesat e panevojshme, dhe të vendosë sipas ligjit [...].*

12. Komisioni në rrugë elektronike, më datë **30.1.2023**, dhe me shkresën nr. ***/** prot., datë **31.1.2023**, i njoftoi subjektit të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik, *vendimin e arsyetuar nr. ****, datë ****1.2023**, të mospranimin të ankimit të subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera, duke arsyetuar se: [...] *vendimi i trupit gjykues është një vendim i ndërmjetëm, që mund të ankimohet veçmas vetëm kur ankimi parashikohet shprehimisht nga ligji. Duke qenë se ligji nuk ka një parashikim të tillë, ky ankim duhet të mos pranohet, pasi është bërë kundër një vendimi ndaj të cilit nuk lejohet ankim. Ky vendim mund të ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar [...].*

13. Në vijim, vëzhguesi ndërkombëtar ka depozituar pranë Komisionit, aktin *Opinion/Mendim, nr. *** prot., datë ***1.2023* (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë ****1.2023**), duke arsyetuar se, bazuar në dokumentet e disponueshme në dosjen e rivlerësimit të subjektit Alfred Balla, vëzhguesi ndërkombëtar është i mendimit të sugjerorë Komisionin të ndërmarrë, ndër të tjera, hapa hetimorë konkretë në drejtim të vlerësimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit.⁸

14. Rezulton se komisioni, në vijim të procedurave standarde të procesit të rivlerësimit, me datë **3.3.2023**, i dërgoi në rrugë elektronike subjektit të rivlerësimit pyetësin nr. 2 me 12 pyetje lidhur me vlerësimin e pasurisë, duke i kërkuar t'u kthejë përgjigje këtyre pyetjeve brenda datës 15.3.2023.

15. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk i është përgjigjur pyetjeve të dërguara nga ana e Komisionit, trupa gjykuese e këtij të fundit i ka dërguar në datën 20.3.2023 një kujtesë për plotësimin e detyrimit ligjor. Në mungesë të reagimit nga ana e subjektit të rivlerësimit, trupa gjykuese e Komisionit, në datën 29.3.2023 i ka dërguar sërish një *email* subjektit të rivlerësimit, duke e informuar se në kushtet e mospërgjigjes prej tij, kjo rrethanë e procesit do të diskutohej në mbledhjen e trupit gjykues të datës 3.4.2023.

⁷ Neni 49, pika 10 [...] *Gjetja e paraqitur në formën e një deklaratë, dokumenti ose raporti i dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë ose standard ligjor, i cili ekziston ose ka ndodhur. Gjetja parashtron rrethanat për konstatimin e bërë. Komisioni ose Kolegji i Apelitit e çmon gjetjen si të barsvlershme me mendimin e dhënë nga një ekspert. Refuzimi i gjetjes bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit ose të Kolegjit të Apelitit [...].*

⁸ Subjekti i rivlerësimit, ndërkohë, i është përgjigjur pyetësorit standard dhe vëzhguesi ndërkombëtar ka sugjeruar veprime hetimore konkrete në drejtim të vlerësimit të pasurisë.

16. Ndërkohë që ana e trupës gjyquese të Komisionit dërgoheshin pyetjet e pyetësorit nr. 2, rezulton se subjekti i rivlerësimit kishte ndërmarrë veprime që lidheshin me kontrollin gjyqësor të kërkuar prej tij, pranë juridiksionit administrativ, për sa i takon statusit të ndihmësit ligjor. Kështu, më datë **.2.2023, subjekti i rivlerësimit kishte depozituar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, kërkesën për heqje dorë nga e drejta e padisë, duke arsyetuar se statusi aktual si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk përputhej me atë të Ndhmësit ligjor të Gjykatës së Lartë. Rezultoi se me vendimin nr. ***, datë **.3.2023, një trupë gjyquese e Gjykatës Administrative të Apelit vendosi të prishë vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe të rrezojë padinë, duke arsyetuar se subjekti i rivlerësimit, në atë gjykim në cilësinë e paditësit, kishte vendosur të hiqte dorë nga e drejta e padisë.

17. Njëkohësisht me heqjen dorë nga e drejta e padisë në juridiksionin gjyqësor, subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Balla, kishte paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor edhe kërkesë për heqje dorë nga njohja/pasja e statusit të Këshilltarit/Ndhmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

18. Teksa trupi gjyqësor i Komisionit ishte në pritje të kthimit të përgjigjeve për pyetësorin nr. 2, lidhur me vlerësimin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit, me shkresën datë **4.4.2023**, protokolluar në Komision me nr.*** prot., duke i bashkëlidhur këtij akti: (i) vendimin nr. ***, datë **.3.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, e cila ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr.***, datë **.7.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe rrezimin e kërkesë padisë...”*; si dhe (ii) kërkesën për heqje dorë nga kërkesa për deklarin e pasjes/njohjes së statusit të Këshilltarit/Ndhmësit ligjor jo magjistrat në Gjykatën e Lartë, dorëzuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë **.3.2023, ndër të tjera, ka parashtruar se: *[...] të dyja këto dokumente së bashku me vendimin që KLGJ-ja do të marrë shumë shpejt mbi kërkesën time, hedhin dritë mbi dyshimet tuaja se mos gëzoj ose do të gëzoj në të ardhmen ndonjë status të Ndhmësit ligjor në Gjykatën e Lartë. Tashmë nuk ka asnjë motiv ligjor, administrativ apo moral që ju të vazhdoni ndaj një përfaqësuesi të një organi Kushtetues, të zgjedhur e kontrolluar nga Kuvendi i Shqipërisë, një proces të kundërligjshëm, i cili nuk duhet të kishte nisur e nuk duhet të vijoj më. Praktika e vendimeve tuaja në këto vite, të cilat ua kam bërë prezent, më jep plotësisht të drejtë në pretendimet e mia [...]*.

19. Bazuar në kërkesën e subjektit të rivlerësimit, z. Alfred Balla, për heqjen dorë nga njohja/pasja e statusit të Këshilltarit/Ndhmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, pak javë më vonë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. ***, datë **.5.2023, vendosi fillimisht *“Shfuqizimin e vendimit të pezullimit me nr. ***, datë **.12.2020, “Për shqyrtimin e kërkesës për pasje/njohje të statusit të Këshilltarit/Ndhmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë, të z. Alfred Balla”*. E më pas, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. ***, datë **.5.2023, vendosi: *“Përfundimin pa vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesës për pasje/njohje të statusit të Këshilltarit/Ndhmësit ligjor jomagjistrat, të z. Alfred Balla, për shkak të heqjes dorë nga kërkesa”*.

20. Me datë **30.5.2023**, pas administrimit të kërkesës së rishtë të subjektit të rivlerësimit për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, trupi gjyqësor i Komisionit i përcolli subjektit të rivlerësimit në rrugë elektronike rezultatet e hetimit, lidhur me procesin e tij të rivlerësimit, duke çmuar kësaj radhe se: *[...] duket se në rastin konkret jemi para zbatimit të nenit 103 të Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet se: “1.Procedimi administrativ*

përfundon kur organi administrativ kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar zbulon se objekti për të cilin kishte filluar procedimi ose qëllimi i vendimit është bërë i pamundur. 2. Deklarimi i përfundimit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni duhet të jetë gjithnjë i arsyetuar dhe kundër tij mund të bëhet ankim në gjykatë [...], si dhe i kërkoi subjektit t'i vërë në dijeni nëse do të marrë pjesë apo jo në seancën dëgjimore, lidhur me procesin e tij të rivlerësimit për të cilën do të njoftohet për datën dhe orën, pas dërgimit të parashkrimeve të subjektit.

21. Subjekti i rivlerësimit, po më datë **30.5.2023**, njoftoi Komisionin në rrugë elektronike: [...] se nuk dëshiron të njihet me prova të tjera dhe as të marr pjesë në seancë dëgjimore. Ky është konkluzion i drejtë [...], përfundonte komunikimin e tij me trupën z. Alfred Balla.

22. Nga aktet në fashikull dhe nga përmbajtja e vendimit nr. 675, datë 16.6.2023, duket se Komisioni, megjithëse paralajmëronte zhvillimin e një seance dëgjimore publike, nuk ka njoftuar subjektin mbi datën dhe orën e zhvillimit të seancës dëgjimore publike, si dhe nuk ka zhvilluar ndonjë seancë dëgjimore publike, sipas parashkrimeve të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

22.1 Komisioni, duke rivlerësuar situatën ligjore dhe faktike të subjektit të rivlerësimit, z. Alfred Balla, ndër të tjera, arsyeton se: [...] Në këto kushte, duke rivlerësuar situatën ligjore dhe faktike të subjektit të rivlerësimit, z. Balla, trupi gjykues çmon se: *Vendimi i largimit nga detyra e Ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë të subjektit është një vendim administrativ, i cili, pavarësisht diskutimeve lidhur me ligjshmërinë e tij, është në fuqi dhe nuk ka asnjë formë ligjore që ai të ndryshohet apo të shfuqizohet;* Ky vendim, qartazi, nuk është një akt që përputhet me vullnetin e subjektit, qoftë edhe në mënyrë të heshtur. Subjekti e kishte bërë këtë akt objekt të ankimit gjyqësor, duke konsideruar faktin se ky vendim nuk ishte për shkaqe ligjore. Ky proces tashmë është i përfunduar, duke vendosur gjykata për rrëzimin e padisë. Për pasojë, ky largim ligjërish duhet të konsiderohet si përfundim i marrëdhënies së punës së subjektit të rivlerësimit për arsye ligjore, tashmë i padiskutueshëm si në rrugë administrative, edhe gjyqësore. Është e provuar se në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka qenë subjekt ex officio i ligjit. Por humbja e këtij statusi nuk ka ardhur si pasojë as e përfundimit të procesit të rivlerësimit, as e dorëheqjes së tij, por si pasojë e një akti që ka vendosur ndërprerjen e marrëdhënies së punës së tij... subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Balla, ka humbur përfundimisht statusin e subjektit të rivlerësimit lidhur me funksionin e tij të mëparshëm, nga i cili u shkarkua (edhe pse është ende në sistem, por për shkak të një ngjarjeje të mëvonshme ligjore nga Kuvendi). Ai nuk ka më vazhdimësi të statusit të subjektit të rivlerësimit, i cili ka ekzistuar deri në momentin që çështja ishte në shqyrtim në Gjykatën Administrative. Për pasojë, nuk është e mundur dhe do të ishte joproporcionale nëse do të trajtohej kjo situatë faktike dhe ligjore në kuptim të nenit G [...].

22.2 Trupa gjykuese e Komisionit, përfundimisht, ka vlerësuar se në rastin konkret jemi para zbatimit të nenit 103 të K. Pr. Administrative dhe ka vendosur: [...] Të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar për z. Alfred Balla [...].

III. Shkaqet e ankimit

23. Komisioneri Publik, në vlerësim të rrethanave dhe fakteve të administruara nga Komisioni, për subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Balla, në konsideratë të qëllimit të përcaktuar

nga neni 179/b i Kushtetutës, jurisprudencës tashmë të konsoliduar të Kolegjit për rastet e ndërprerjes/përfundimit të procesit të rivlerësimit, si dhe mendimit/opinionit dhe gjetjeve të vëzhguesit ndërkombëtar, çmon se vendimi i Komisionit nuk është i drejtë dhe i bazuar në situatën faktike të dokumentuar nga aktet në fashikull dhe nuk gjen mbështetje në kuadrin kushtetues e ligjor të zbatueshëm.

24. Si parashtrësë të shkaqeve të ankimit dhe analizës mbi statusin si subjekt rivlerësimi të z. Balla, Komisioneri Publik, duke ndarë të njëjtin qëndrim me vëzhguesin ndërkombëtar të ONM-së, vlerëson të vendosë në vëmendje të Kolegjit, *Mendimin/Opinionin* me shkrim të dhënë nga ky vëzhgues, të administruar në dosje të Komisionit me nr. *** prot., datë **.6.2022, mendim/opinion, i cili, bazuar në nenin 49 të ligjit nr. 84/2016, konsiderohet një përfundim i dhënë për një rrethanë konkrete gjatë procesit të rivlerësimit.

24.1 Vëzhguesi ndërkombëtar, në duke parashtruar një analizë ligjore shteruese të rrethanave të rastit konkret, ndër të tjera, shprehet se: [...] 1. z. Balla, ishte subjekt rivlerësimi në kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese që rregullonin procesin e rivlerësimit. 2. Pavarësisht se kryetari i Gjykatës së Lartë me urdhrin nr. ***, datë **.7.2017, ka vendosur lirimin nga detyra të z. Balla, ka një proces gjyqësor në vijim, në të cilin Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, është shprehur me vendimin nr. ***, datë **.7.2021. Në këtë vendim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka njohur faktin se akti i lirimimit nga detyra me nr. ***, datë **.7.2017, është akt i nxjerrë jashtë kompetencave të Kryetarit të Gjykatës (ultra vires), ndaj është absolutisht i pavlefshëm dhe nuk mund të prodhojnë pasoja ligjore...3. Duhet nënvizuar se në këtë proces gjyqësor, që tashmë është në Apel, z. Balla, pretendon njohjen e statusit si Këshilltar ligjor jomagjistrat, duke pranuar se e ka statusin e subjektit dhe pasi është liruar nga detyra nga Kryetari i Gjykatës së Lartë; 4. Pra, në mënyrë të arsyeshme arrihet në përfundimin se, bazuar në një analizë ligjore të vendimit të Gjykatës, z. Balla mbante statusin e subjektit si këshilltar ligjor jomagjistrat, edhe pas nxjerrjes së urdhrit nr.***, të Kryetarit të Gjykatës, i cili ishte absolutisht i pavlefshëm dhe pa pasoja. 5. Vendimi i gjykatës, gjithashtu, ka vendosur që z. Balla ka humbur statusin e këshilltarit ligjor (dhe të drejtat nga ky status) vetëm kur u zgjodh si anëtar i KLP-së me vendimin nr.19/2018, botuar në Fletoren Zyrtare më 14.2.2018. Si rrjedhojë, dhe dëmshpërblimi iu caktua z. Balla bazuar në rrogat e papaguara deri në këtë datë; 6. Në një situatë ku z. Balla nuk do ishte liruar (jo ligjërisht) nga detyra e tij, ai do ushtronte shërbimin në sistemin e drejtësisë. Fillimisht, në Gjykatën e lartë (si Këshilltar ligjor jo magjistrat) dhe më pas në Këshillin e Lartë të Prokurorisë si magjistrat. Por në të dyja rastet, ai do mbante statusin si subjekt rivlerësimi dhe do ishte nënshtruar procesit të rivlerësimit; 7. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit mundet në mënyrë incidentale të përcaktojë statusin e subjektit të rivlerësimit të z. Balla gjatë procesit të rivlerësimit, pa pasur nevojën e një vendimi final të gjykatës që e referon atë; 8. Përfaqësuesi ndërkombëtar është tërësisht i vetëdijshtëm dhe për jurisprudencën e Kolegjit, në vendimin (JR) nr. 2/2021, ku Kolegji ka bërë të qartë dallimin midis statusit të subjektit të rivlerësimit, që duhet t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit dhe ekzistencës ose jo të statusit të magjistratit⁹. Ndaj, është e qartë se ka subjekte rivlerësimi që janë njëherësh magjistrat dhe subjekte që nuk janë magjistrat; dhe statusi i subjektit të rivlerësimit duhet të përcaktohet në konsideratë të pozitës specifike që ka personi në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese që rregullojnë procesin e rivlerësimit,

⁹ Në rastin konkret, i referohemi statusit të Ndihmësit ligjor.

dhe duhet të mbahet për sa kohë personi qëndron në sistemin e drejtësisë, besimin në të cilin synon të rivendosë ky proces; 9. Në rastin tonë duket se subjekti ka paraqitur kërkesë në KLGJ për njohjen e statusit si Këshilltar ligjor jomagjistrat, dhe në rast se dhe Gjykata e Apelit lë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, kjo situatë nuk ndikon në përcaktimin e z. Balla si subjekt rivlerësimi, nga momenti që ndryshimet kushtetuese kanë hyrë në fuqi [...].

24.2 Në vijim të depozitimit nga ana e Vëzhguesit Ndërkombëtar të këtij mendimi/opinionit, trupa gjyquese e Komisionit, sikundër u tha më lart në këtë ankim, e ka vazhduar procedurën e rivlerësimit për z. Alfred Balla, duke e konsideruar subjekt rivlerësimi, si dhe ka i dërguar subjektit të rivlerësimit dy pyetësorë,¹⁰ në drejtim të vlerësimit të pasurisë, procedurë e cila ka zgjatur deri më datë **30.5.2023**, kur Komisioni i ka dërguar subjektit rezultatet e hetimit, duke konkluduar me përfundimin e procesit të rivlerësimit pa vendim përfundimtar.

24.3 Nga aktet në fashikullin e Komisionit, Komisioneri Publik nuk vlerëson se që prej momentit që vëzhguesi ndërkombëtar ka dhënë *Mendimin/Opinionin* e tij për statusin e subjektit, më datë **6.6.2022**, dhe Komisioni më datë **9.11.2022**, ka vendosur për vazhdimin e procesit të rivlerësimit për z. Alfred Balla, duke e vlerësuar në tërësinë e rrethanave ligjore dhe faktike, si një subjekt të ligjit nr. 84/2016, të ketë ndryshuar ndonjë rrethanë, që të ndryshonte cilësinë e z. Alfred Balla si subjekt rivlerësimi, në mënyrë të tillë, që në rezultatet e hetimit të datës **30.5.2023**, trupa gjyquese e Komisionit të dilte në një përfundim të ndryshëm, duke konstatuar se z. Alfred Balla nuk e gëzonte më cilësinë e subjektit të rivlerësimit.

24.4 Për më tepër, nga vëzhguesi ndërkombëtar, deri në datën e përcjelljes së rezultateve të hetimit nga ana e trupës gjyquese të Komisionit, janë përcjellë në Komision dy akte të tjera që lidhen me procesin e rivlerësimit të z. Alfred Balla, përkatësisht: (i) *Gjetje dhe mendim/opinion, datë 26.1.2023*, që bazuar në nenin 49 të ligjit nr. 84/2016, përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë ose standard ligjor, *mbi mospranimin e ankimit të z. Balla për pezullimin e procesit të rivlerësimit, dhe mosdërgimin e dosjes në Kolegj për të shmangur vonesat e panevojshme, dhe të vendosë sipas ligjit*; si dhe (ii) *Opinion/Mendim, datë 31.1.2023*, duke arsyetuar se, bazuar në dokumentet e disponueshme në dosjen e rivlerësimit të subjektit z. Alfred Balla, vëzhguesi ndërkombëtar është i mendimit që Komisioni duhet të ndërmarrë, hapa hetimorë të përshtatshëm në drejtim të vazhdimin të zakonshëm të vlerësimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit, duke sugjeruar të ndjekë çështjet e ngritura nga përfaqësuesi ndërkombëtar në këtë dokument.¹¹

25. Komisioneri Publik, duke mbështetur vlerësimin e vëzhguesit ndërkombëtar, mbi statusin e subjektit dhe ecurinë e procesit të rivlerësimit, konstaton se arsyetimi i Komisionit se: [...] *subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Balla, ka humbur përfundimisht statusin e subjektit të rivlerësimit lidhur me funksionin e tij të mëparshëm, nga i cili u shkarkua (edhe pse është ende në sistem, por për shkak të një ngjarjeje të mëvonshme ligjore nga Kuvendi) [...], nuk gjen mbështetje në ligj, në jurisprudencën e Kolegjit, dhe as në rrethanat faktike të rastit konkret.*

26. Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 parashikojnë, në mënyrë të shprehur dhe shteruese, subjektet që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit dhe ecurinë e procesit, pavarësisht dinamikës së rrethanave që ndikojnë në pozicionin për shkak të të cilit individët kanë fituar statusin e

¹⁰ Pyetësori i dytë me *email*-in e datës 3.3.2023.

subjektit të rivlerësimit. Referuar vërtetimit datë **.9.2017, të Gjykatës së Lartë, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Balla, ka punuar pranë Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë me detyrën e Ndhmësit ligjor, nga data **.4.2014 deri në datën **.9.2017¹².

27. Komisioneri Publik, në analizë të kuadrit kushtetues, ligjor dhe në vlerësim të rrethanave faktike që i përkasin subjektit, konstaton se në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë¹³, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, subjekti i rivlerësimit ushtronte funksionin e Ndhmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë. Ndhmësit ligjorë të Gjykatës së Lartë kategorizohen në rrethin e subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, edhe nga ligji nr. 84/2016, në vijim të parashikimeve të neneve 3, pika 16¹⁴ e tij.

28. Komisioneri Publik, sikundër Kolegji, ka arsyetuar në jurisprudencën e tij, ashtu sikurse ka vlerësuar vëzhguesi ndërkombëtar, konstaton se qartazi, në momentin kur u miratuan dhe hynë në fuqi ndryshimet kushtetuese, korrik dhe gusht 2016, ku parashikohet kryerja e procesit të rivlerësimit kalimtar, z. Alfred Balla ushtronte funksionin e Ndhmësit ligjor, është subjekt i rivlerësimit dhe, si i tillë, duhet t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit. Në praktikën e konsoliduar të Kolegjit, jo domosdoshmërisht subjektet e rivlerësimit, në momentin kur fillonte procedura e rivlerësimit, mbanin të njëjtën detyrë funksionale për të cilën *ex officio*, Kushtetuta dhe ligji i kanë parashikuar si subjekte rivlerësi.

29. Kolegji ka arsyetuar se: [...] *Në kushtet kur ndryshimet kushtetuese që normuan rivlerësimin e gjetën subjektin e rivlerësimit në një nga detyrat e përmendura nominalisht nga pika 3 e kësaj dispozite, ajo ishte subjekt rivlerësi ex officio. Ky fakt qëndron, është i pakontestueshëm dhe autonom nga momenti kur statusi i magjistratit deklarohet i mbaruar nga institucionet përkatëse...nëse, nga procesi i rivlerësimit do të përjashtoheshin me sukses të gjithë subjektet që nuk ishin në detyrë në momentin kur u vinte radha të shortheshin apo çështja e tyre të shqyrtohej nga Komisioni, gjatë gjithë harkut kohor prej 5 vjetësh, që përbën mandatin e këtij të fundit, megjithëse e gëzonin këtë cilësi me hyrjen në fuqi të ligjit, procesi i rivlerësimit do të përfshinte subjektet mbi baza tejet rastësore, të kushtëzuara thjesht nga shorti i Komisionit dhe përfundimi ose jo i rivlerësimit deri në momentin në kohë kur, për një arsye të caktuar, nuk kryenin më detyrën që i kishte cilësuar si subjekte rivlerësi*¹⁵[...].

30. Duke iu referuar jurisprudencës ekzistuese për një situatë të ngjashme kushtetuese, ligjore dhe faktike me subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Balla, ndër të tjerë, Kolegji është shprehur me vendim përfundimtar edhe për subjektin e rivlerësimit ***.***, lidhur me pasojën e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit.

31. Në analizë të kuadrit ligjor në fuqi dhe qëllimit të ligjvënësit, me ndryshimet kushtetuese dhe ligjore të reformës në drejtësi, statusi ligjor dhe vijimësia e detyrës për Ndhmësit ligjorë

¹² Referohuni vendimit (JR) nr. 39/2020, prg.16.

¹³ Të gjithë Këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, Ndhmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, Ndhmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen *ex officio*. Procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet.

¹⁴ 1. "Subjekt i rivlerësimit" janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës. [...] dhe 42, pika 2 "[...] Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, Ndhmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe Ndhmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës".

¹⁵ Referohuni vendimit (JR) nr. 5/2021, prg. 36.3.

që kanë qenë në detyrë pranë Gjykatës së Lartë në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 98/2016, përcaktohej nga ligji nr. 96/2016. Në nenin 165 të këtij ligji, parashikohet se Ndhmësit ligjorë jo magjistratë pranë Gjykatës së Lartë, janë subjekte rivlerësimi *ex officio*, në referim të nenit 179/b, pika 4, të Kushtetutës, dhe ligjit nr. 84/2016, dhe njëkohësisht janë subjekte të ligjit nr. 96/2016, sa i përket statusit të tyre, fillimit dhe përfundimit të marrëdhënies së punës.

32. Detyra funksionale e subjektit të rivlerësimit, z. Balla, mbaroi në muajin korrik 2017, ndërsa dorëzimi i detyrës u krye në shtator 2017, pra rreth 11 muaj pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese (11.8.2016), rreth 7 muaj pas fillimit të zbatimit të ligjit nr. 84/2016 (19.1.2017)

33. Në përfundim, të kësaj analize, mbi kuadrin ligjor të zbatueshëm dhe jurisprudencën e Kolegjit, Komisioneri Publik vlerëson se z. Alfred Balla e ka fituar *statusin ligjor të subjektit të rivlerësimit*, që në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve Kushtetuese e, për pasojë, do të duhej t'i nënshtrohej *ex officio* procesit të rivlerësimit kalimtar, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, i cili rregullon këtë proces.

34. Arsyetimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Balla: [...] *ka humbur statusin e subjektit të rivlerësimit, jo si pasojë e përfundimit të procesit të rivlerësimit, apo e dorëheqjes së tij, por si pasojë e një akti që ka vendosur ndërprerjen e marrëdhënies së punës së tij* [...] bie ndesh me Kushtetutën dhe ligjin dhe nuk përputhet as me përmbajtjen e akteve në fashikull. Qëllimi i procesit është rivlerësimi kalimtar i të gjithë subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisht së sistemit të drejtësisë dhe rikthimin e besimit të publikut te institucionet e këtij sistemi.

35. Komisioneri Publik, në analizë të rrethanave faktike në raport me legjislacionin e zbatueshëm, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit të referuar më lart në këtë ankim, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, pavarësisht se nuk ushtronte detyrën e Këshilltarit ligjor, në momentin e zhvillimit të procesit në Komision, vazhonte të ruante statusin e subjektit të rivlerësimit dhe në këto kushte, procesi i rivlerësimit ndaj tij mundej të përfundohej me rivlerësimin e tri kritereve apo për shkak të vullnetit të tij ose të ndërprerjes.

36. Situata faktike në të cilën gjendej subjekti i rivlerësimit kushtëzohej nga dy faktorë njëkohësisht, mosushtrimi i detyrës të këshilltarit ligjor dhe pasja e statusit të subjektit të rivlerësimit, rrethanë e cila kërkonte një vlerësim specifik në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 84/2016, si ligji i veçantë i zbatueshëm për situatën konkrete dhe, për më tepër, që parashikon një rregullim të posaçëm për situata të tilla.

37. Në këtë kuadër, Komisioneri Publik sjell në vëmendje se ligjbërësi ka parashikuar rastet për përfundimin e procesit për subjektet e rivlerësimit, ndër të cilët ishte edhe z. Alfred Balla, kalim me sukses i procesit të rivlerësimit dhe konfirmim në detyrë, shkarkim nga detyra ose ndalim kushtetues prej 15 vjetësh për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë. Për Këshilltarët ligjorë jomagjistratë, alternativa e parë – kalimi me sukses i procesit mund të shoqërohet edhe me fitim të statusit të magjistratit pas programit të përshpejtuar, nëse zgjedhin ta ndjekin atë alternativë profesionale¹⁶.

¹⁶ Sa më sipër, në mënyrë të shprehur, pavarësisht testimit apo jo në Shkollën e Magjistraturës, ligjvënësi i ka kategorizuar Ndhmësit ligjorë të Gjykatës së Lartë si subjekte të rivlerësimit.

38. Komisioneri publik vlerëson gjithashtu se arsyetimi i Komisionit se: [...] *vendimi i largimit nga detyra e Ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë të subjektit është një vendim administrativ, i cili, pavarësisht diskutimeve lidhur me ligjshmërinë e tij, është në fuqi dhe nuk ka asnjë formë ligjore që ai të ndryshohet apo të shfuqizohet* [...] nuk gjen mbështetje në legjislacionin e zbatueshëm, jurisprudencën e Kolegjit, aktet në dosje dhe as në analizën e veprimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit në drejtim të përcaktimit të ligjshmërisë së këtij akti administrativ dhe raportin e tij me procesin e rivlerësimit.

39. Komisioneri Publik, ashtu sikurse Kolegji ka arsyetuar në jurisprudencën e tij¹⁷, çmon se vlerësimi i urdhrin të kryetarit të Gjykatës së Lartë lidhur me marrëdhënien e punësimit të subjektit të rivlerësimit, z. Alfred Balla, si Ndihmës ligjor, është paralel dhe, për pasojë, pa asnjë peshë mbi faktin që subjekti i rivlerësimit e kishte fituar këtë cilësi në mënyrë të shprehur në parashikimin e nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës, ashtu sikurse arsyetuar dhe më lart. Mungesa e ndikimit të këtij akti është e njëjtë edhe për vijimin e statusit të Ndihmësit të ligjor për subjektin e rivlerësimit, deri në momentin e zgjedhjes anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

40. Në çdo rrethanë, Komisioneri Publik, duke ndarë të njëjtin mendim me vëzhguesin ndërkombëtar në raport me urdhrin nr. ***, datë **.7.2017, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, vlerëson se Komisioni mundej, qoftë edhe kryesisht në mënyrë *incidentale*, të konstatonte pasojat e vlefshmërisë së këtij urdhri, jo në raport me marrëdhënien e punës, por në raport me ecurinë e procesit të rivlerësimit dhe efektet mbi statusin e subjektit të rivlerësimit të z. Alfred Balla gjatë këtij procesi, për më tepër në kushtet kur pa filluar hetimi administrativ nga Komisioni në datën **9.11.2022** dhe dërguar pyetëtori i parë, subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Balla, ia kishte nënshtruar ai vetë këtë urdhër kontrollit gjyqësor, duke kërkuar, ndër të tjera, sikundër u parashtrua më lart: [...] *Detyrimin e palës së paditur t'i njohë të drejtën e rikthimit të paditësit në pozicionin e Këshilltarit jomagjistrat në Gjykatën e Lartë, pas mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për shkak se kishte statusin e këshilltarit ligjor në momentin e emërimit në KLP; Detyrimin e palës së paditur t'i shpërblejë paditësit dëmin nga ndërprerja e marrëdhënies së punës në vlerën e pagave për periudhën datë **.9.2017 deri më datë **.12.2018, për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies nga organi jokompetent* [...]¹⁸.

41. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, me vendimin nr. ***, datë **.7.2021, lidhur me kërkesën objekt padie të subjektit të rivlerësimit, z. Balla, ndër të tjera, ishte shprehur se: [...] *nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit nr. 98/2016, emërimi i Këshilltarëve ligjorë, jomagjistratë në Gjykatën e Lartë është kompetencë ekskluzive e Këshillit të Lartë Gjyqësor... Për pasojë akti i lirimit nga detyra me nr. ***, datë **.7.2017, janë akte të nxjerra jashtë kompetencave të Kryetarit të Gjykatës, parashikuar në nenin 37 të ligjit nr. 98/2016, dhe për pasojë, në referim të nenit 108, shkronja "a", pika "i", dhe nenit 110, pika 1, të K. Pr. Administrative, janë akte absolutisht të pavlefshme dhe nuk mund të prodhojnë pasoja*

¹⁷ Referohuni vendimit (JR) nr. 39/2020.

¹⁸ Nga aktet rezultojnë se në seancën gjyqësore përgatitore të datës 25.5.2021, pala paditëse, z. Alfred Balla, ka kërkuar saktësimin e objektit të padisë nga objekti fillestar që ishte: [...] Detyrimin e palës së paditur t'i njohë statusin e Këshilltarit ligjor jomagjistrat në Gjykatën e Lartë e të rikthejë Alfred Ballën në detyrën e Këshilltarit ligjor pranë kësaj Gjykate, si pasojë e pavlefshmërisë së urdhrin nr. ***, datë **.7.2017, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë. Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditësit pagën nga data **.9.2017 deri në datën **.12.2018 (ditë e konstituimit të KLP-së). Detyrimin e palës së paditur të paguajë të gjitha shpenzimet procedurale gjyqësore [...].

ligjore...kjo gjykatë vlerëson se me zgjedhjen e paditësit si anëtar i KLP-së nga shoqëria civile, me vendimin nr.19/2018 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, paditësi, me vullnetin e tij, ka zgjedhur që të jetë pjesë e KLP-së, si përfaqësues i shoqërisë civile dhe, rrjedhimisht, ka hequr dorë nga çdo e drejtë që rrjedh nga statusi si Ndhimësligjor pranë kësaj Gjykate [...].

42. Referuar objektit të kërkesëpadisë së subjektit të rivlerësimit, e datës ****9.2020**, konstatohet edhe interpretimi ligjor që vetë subjekti i rivlerësimit ka pasur për ekzistencën e statusit të tij, vullneti i tij për t'u rikthyer në pozicionin e mëparshëm si Këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë, pas mbarimit të mandatit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, për shkak të gëzimit të statusit të Ndhimësit/Këshilltarit ligjor në momentin e emërimit si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

43. Sa më sipër, Komisioneri Publik, duke abstraguuar nga vlefshmëria ose jo e urdhrit të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, nisur edhe nga jurisprudenca e Kolegjit, e materializuar në vendimin (JR) nr. 39/2020, bazuar në opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar, vlerëson se Komisioni kishte kompetencën për të konstatuar se efektet e urdhrin nr. ***, datë **.7.2017, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, nuk ndikonin në ecurinë e procesit të rivlerësimit të subjektit z. Alfred Balla, në kushtet kur: (i) subjekti kishte statusin e padiskutueshëm të subjektit të rivlerësimit; (ii) Kushtetuta dhe ligji ia kishin njohur vazhdimësinë në detyrë të Ndhimësve /Këshilltarëve ligjorë, duke rregulluar procedurat dhe përcaktuar organet përgjegjëse për karrierën e tyre, të ndryshëm nga Kryetari i Gjykatës së Lartë; (iii) Vetë subjekti i rivlerësimit, në interpretim të ligjit, argumentonte se gëzonte statusin e Këshilltarit ligjor dhe kishte shfaqur interesin për të vijuar më tej të jetë pjesë e sistemit të drejtësisë; (iv) Kontrolli gjyqësor i ushtruar mbi kërkimin e vetë subjektit të rivlerësimit kishte konstatuar moscenimin e statutit të Ndhimësit ligjor nga aktet absolutisht të pavlefshme të nxjerra në kundërshtim me ligjin.

44. Në këto rrethana ligjore dhe faktike, konstatohet se vendimi i Komisionit nuk gjen mbështetje në qëllimin e legjislatorit që Ndhimësit ligjorë të Gjykatës së Lartë t'i nënshtrohen procesit të rivlerësimit. Legjislacioni që normon procesin e rivlerësimit parashikon qartësisht se institucionet e rivlerësimit duhet të rivlerësojnë subjektet e përcaktuara shprehimisht në pikat 3 dhe 4, të nenit 179/b, të Kushtetutës. Në rast se këto subjekte vendosin të mos i nënshtrohen këtij procesi, atëherë ata përjashtohen nga mundësia e emërimit në disa prej organeve të drejtësisë, për një periudhë 15-vjeçare, sipas përcaktimeve në pikën 2, të nenit G, të aneksit të Kushtetutës.

45. Parashikimi i nenit G të aneksit të Kushtetutës është shterues. Kolegji në jurisprudencën e tij është shprehur se ndërprerja e procesit të rivlerësimit shoqërohet, pashmangshmërisht, me ndalimin ligjor për t'u emëruar në pozicione specifike për 15 vjet. Kjo dispozitë zbatohet për të gjitha kategoritë e funksionarëve të sistemit të drejtësisë që, në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, kanë fituar statusin subjekt rivlerësimi, pa bërë dallime ndërmjet tyre, qoftë kjo edhe për shkak të kohëzgjatjes së kufizuar të ushtrimit të detyrës.

46. Në këto rrethana, vazhdimi i procesit të rivlerësimit për subjektin z. Alfred Balla ishte parakusht i padiskutueshëm dhe, në kuptim të parashikimeve kushtetuese, lidhur me procesin e rivlerësimit, duke qenë se qëllimi i procesit është rivlerësimi kalimtar i të gjithë subjekteve të rivlerësimit, për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, dhe për shkak të ushtrimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit, në një nga organet më të larta kushtetuese, ku

ndërpreja e procesit të rivlerësimit parashikohet si pengese ligjore për emërimin për një periudhë 15-vjeçare.

47. Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se arsyetimi i Komisionit, ku interpreton se në rastin konkret jemi para zbatimit të nenit 103 dhe nenit 95, të K. Pr. Administrative, nuk është i drejtë dhe nuk gjendet në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm dhe jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit. Bazuar në rrethanat e çështjes, zbatimi i normës së përgjithshme, *lex generalis*, sipas parashikimit të nenit 95 të Kodit të Procedurës Administrative, ndërkohë që ekziston parashikimi i posaçëm *lex specialis*, sipas nenit G, të aneksit të Kushtetutës dhe rregullimeve të ligjit nr. 84/2016, e bën të gabuar qëndrimin e mbajtur nga Komisioni, për sa i përket identifikimit të ligjit të zbatueshëm në rrethanat faktike konkrete.

48. Në këtë kuadër, Komisionit, ashtu sikurse Kolegji ka vepruar në jurisprudencën e tij, i mbetej dhe duhej të verifikonte vullnetin e tij për të mos iu shmangur dhe përfunduar procesin e rivlerësimit.

49. Duke u rikthyer në rrethanat faktike dhe ligjore të çështjes konkrete, Komisioneri Publik konstaton se, lidhur me vullnetin për t'iu shmangur procesit, subjekti i rivlerësimit, që në datën **6.2018, protokolluar në Komision me nr. *** prot., ka paraqitur **kërkesën për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit**, ku, ndër të tjera, shprehet se: [...] Në bazë të dispozitave të paketës ligjore të reformës në drejtësi të vitit 2016, unë nuk e kam pasur dhe nuk e kam statusin e magjistratit (gjyqtar ose prokuror). I vetmi benefi i ofruar për ne nga ligji ishte se, këtë status mund ta fitoja nëse do t'i nënshtrrohesha provimit të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e ish-ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë e, pasi të kualifikohesha, të ndiqja një vit studim pranë kësaj shkolle. Këtë të drejtë unë nuk e shfrytëzoja, pasi nuk kisha interes dhe në datën 8.2.2018, me vendim nr.19/2018 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, jam zgjedhur anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga shoqëria civile. Gjatë procedurës së kandidatimit tim pranë organit Kushtetues të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kam qenë subjekt i kontrollit të figurës, anës profesionale dhe pasurisë sime nga organet e caktuara me ligj... Duke pasur parasysh qëllimin e ligjit për rivlerësimin kalimtar që ka për objekt kontrollin për gjyqtarët, prokurorët dhe këshilltarët ligjorë aktualisht në detyrë..., vlerësoj se unë nuk jam më subjekt i kontrollit sipas ligjit nr. 84/2016, ndaj procedura e rivlerësimit kalimtar (Vetingut) ndaj meje duhet ndërprerë [...].

50. Sa i takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se është zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe, për rrjedhojë, ka qenë subjekt i kontrollit të figurës, pasurisë dhe aspektit profesional, Komisioneri Publik, ashtu sikurse Kolegji, ka arsyetuar në praktikën e tij¹⁹, në drejtim të identifikimit të parashikimeve ligjore, konstaton se neni 179/b i Kushtetutës dhe neni 4 i ligjit nr. 84/2016, përcaktojnë në mënyrë të plotë arsyet e nisjes së procesit të rivlerësimit kalimtar, duke synuar, ndër të tjera, *kthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë*, përcaktojnë organet kompetente që do të kryejnë procesin e rivlerësimit kalimtar, duke identifikuar si të tilla Komisionin, Komisionerin Publik dhe Kolegjin e Posaçëm të Apelit, përcaktojnë subjektet që *ex officio* i nënshtrohen këtij procesi, si dhe evidentojnë pasojat e moskalimit me sukses të tij²⁰.

¹⁹ Referohuni vendimit (JR) nr.16/2023, prgr.16.18.

²⁰ Në këto kushte, çdo vlerësim tjetër i pasurisë, figurës apo profesionalizmit të subjekteve të rivlerësimit, i kryer në kuadër të procedurave/proceseve të tjera, të cilat janë jashtë objektivit të kontrollit të ushtruar sipas legjislacionit të zbatueshëm për

51. Ndërkohë, sikurse është parashtruar më lart, teksa nga njëra anë kërkonte ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik rithekson se subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Balla, urdhrin nr. ***, datë **.7.2017, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, për lirimin nga detyra, e ka bërë objekt të ankimit gjyqësor, duke iu drejtuar juridiksionit gjyqësor me kërkesëpadinë e datës **.9.2020, ku, ndër të tjera, shprehet se: [...] *Kam pritur të krijohej KLGJ e të rishikonte aktet në kapërcim të kompetencave të ish-Kryetarit të Gjykatës së Lartë. Në dhjetor 2018 u konstitua KLGJ-ja dhe ende deri më sot nuk e ka trajtuar procedurën e lirimit tim nga detyra dhe të ndihmësve ligjorë. Kam dijeni se njëra ndihmëse ***,*** i është drejtuar KLGJ-së për njohje statusi dhe KLGJ-ja, me vendimin nr.***, datë **.5.2020²¹, ka vendosur deklarinimin e pasjes së statusit Këshilltar/Ndihmës ligjor jomagjistrat në Gjykatën e Lartë të znj. ***,***.[...].*

52. Po ashtu, sikundër përmendur më lart në këtë ankim, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar me kërkesë me shkrim Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke i kërkuar njohjen/pasjen e statusit të Këshilltarit ligjor pranë Gjykatës së Lartë. KLGJ-ja, me vendimin e saj nr. ***, datë **.12.2020, ka vendosur pezullimin e shqyrtimit të kërkesës së paraqitur për deklarinimin e pasjes dhe mospasjes së statusit të Këshilltarit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë, për shkak se kërkesa është në shqyrtim para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

53. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, në vendimin nr. ***, datë **.7.2021, ndër të tjera, arsyeton mbi: [...] *pavlefshmërinë absolute të urdhrin nr.***, datë **.7.2017, dhe faktit se subjekti i rivlerësimit gëzonte statusin deri kur me zgjedhjen e tij si anëtar i KLP-së, ku paditësi ka humbur çdo të drejtë që rrjedh nga qenia e tij si Ndihmësligjor në Gjykatën e Lartë* [...]. Përtej sa konstatonte gjykata në vendim, vetë subjekti i rivlerësimit, duke synuar pranimin e plotë të objektit të padisë të paraqitur në shkallën e parë të gjykimit dhe për shkak të gëzimit të statusit, kërkonte edhe rikthimin në detyrën e Këshilltarit ligjor të Gjykatës së Lartë, pas përfundimit të mandatit si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

54. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin e paraqitur, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] *Akti i lirimit nga detyra...është akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin dhe, në bazë të nenit 108 dhe 110 të K. Pr. Administrative, nuk mund të prodhojë pasoja juridike me statusin ligjor të paditësit. Paditësi... nuk i cenohet e drejta e pasjes së statusit të këshilltarit jomagjistrat në momentin e zgjidhjes në një organ kushtetues, edhe për faktin se detyra që ushtron aktualisht është në një pozicion më të lartë (anëtar i një organi vendimmarrës) dhe në organet e qeverisjes së pushtetit gjyqësor dhe, për më tepër, edhe gëzon statusin e magjistratit për këtë periudhë. Pikërisht kjo e drejtë e paditësit pjesa e statusit të Ndihmësit/Këshilltar ligjor magjistrat në momentin e nxjerrjes së aktit dhe në momentin e zgjedhjes si anëtar i KLP-së nuk mund të cenohet nga një vendim absolutisht i pavlefshëm dhe në kundërshtim me parashikimet ligjore [...].*

rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk parashikohet të sjellë pasoja juridike në rezultatet e kontrollit të ushtruar nga institucionet e rivlerësimit.

²¹ Nga burime të hapura informacioni, referuar faqes zyrtare të KLGJ-së, konstatohet se Këshilli i Lartë Gjyqësor, në ushtrim të funksioneve të tij kushtetuese dhe ligjore, bazuar në nenin 179/b, pika 4, të Kushtetutës, nenin 165, të ligjit nr. 96/2016, nenin 34 dhe 84, pika 4 të ligjit nr. 98/2016, si dhe nenin 97, pika 1, germa "a", ka nxjerr vendimin nr. ***, datë **.5.2020, përmes së cilit ka deklaruar pasjen e statusit të Këshilltarit/Ndihmësit ligjor jomagjistrat, në Gjykatën e Lartë të znj.***, për të cilën referon subjekti i rivlerësimit.https://klgj.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-Nr.-***-dat%20c3%ab-*.05.2020-Pe%20cc%88r-ke%20cc%88rkese%20cc%88n-e-znj-.....pdf

55. Sikurse u parashtrua edhe me lart në këtë ankim, kur nga ana e trupës gjykuese të Komisionit vijoi dërgimi i pyetësorëve të procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Balla, ka depozituar pranë sekretarisë së Gjykatës Administrative të Apelit, kërkesën datë ****2.2023**, me objekt: **“Për heqje dorë tërësisht nga e drejta e padisë”**, me arsyetimin: [...] *se bazuar në nenin 201/a të K. Pr. Civile, paraqes këtë kërkesë për heqje dorë tërësisht nga e drejta e padisë, pasi mendoj se statusi aktual pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk përputhet me atë të ndihmësit ligjor, ku jam larguar në nëntor të vitit 2017 [...]*²².

56. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit, më datë ****3.2023**, i është drejtuar organit të KLGJ-së, me **kërkesën për heqjen dorë nga kërkesa për deklarimin e pasjes/njohjes së statusit të Këshilltarit/Ndihmësit ligjor jomagjistrat në Gjykatën e Lartë**, duke arsyetuar se: [...] *duke qenë se tashmë ka përfunduar gjykimi në të dyja shkallët e tij dhe unë mendoj se pozicioni im aktual si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk pajtohet me statusin e Ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë, heq dorë nga kërkesa drejtuar para jush në vitin 2020 dhe pushimin e shqyrtimit të saj [...]*.

57. KLGJ, me vendimin nr. *******, datë ****5.2023**, ka vendosur shfuqizimin e vendimit për pezullimin e shqyrtimit të kërkesës për pasje/njohje të statusit të Këshilltarit/Ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë gjykatës së lartë, të z. Alfred Balla. KLGJ, me vendimin nr. *******, datë ****5.2023**, ka vendosur për përfundimin pa vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesës për pasje/njohje të statusit të Këshilltarit/Ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë të z. Alfred Balla, *për shkak të heqjes dorë nga kërkesa*.

58. Në analizë të sa më sipër trajtuar, bazuar në aktet në dosje, rezulton se z. Alfred Balla ka pasur statusin e subjektit të rivlerësimit dhe statusin e ndihmësit ligjor të Gjykatës së Lartë, më së paku, deri në momentin kur ka shprehur vullnetin e tij të pavesuar për të aplikuar/zgjedhur në organin kushtetues të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndërkohë që kishte shprehur njëkohësisht edhe vullnetin e tij për të mos iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, të konfirmuar në korrespondencën e tij të vazhdueshme me Komisionin²³.

59. Komisioneri Publik vlerëson se të gjitha veprimet e kryera prej tij lidhur me procesin e rivlerësimit, përfshirë edhe vetë heqjen dorë nga e drejta e padisë së paraqitur për gjykim nga

²² Gjykata Administrative e Apelit, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] *vlerëson të theksojë se, në rastin kur i paraqitet kërkesa për heqjen dorë nga e drejta e padisë në çdo fazë dhe shkallë gjykimi, gjykata shqyrton vetëm bazueshmërinë në ligjin procedural të kësaj kërkesë dhe disponon për të... ligjvënësi përcakton shprehimisht që në rast pranimit të kërkesës për heqjen dorë nga e drejta e padisë, në çdo rast, në shkallë të parë rrëzohet padia vetëm për këtë motiv, ndërsa kur kërkesa paraqitet në shkallë të tjera të gjykimit, gjykata më e lartë prish vendimin e gjykatës më të ulët dhe rrezon kërkesëpadinë [...]*.

²³ (1) Subjekti i rivlerësimit, me datë ****6.2018**, ka paraqitur në Komision kërkesën për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, ku, ndër të tjera, shprehet se vlerësoj se unë nuk jam më subjekt i kontrollit sipas ligjit nr.84/2016, ndaj procedura e rivlerësimit kalimtar (Vetëingut) ndaj meje duhet ndërprerë. (2) Me *email*-in e datës 6.1.2022, subjekti i rivlerësimit rivendos në vëmendje të Komisionit kërkesën për ndërprerje të vitit 2018, ndër të tjera, pretendon se një proces i tillë Vetëingut nuk më duhet se nuk kam statusin e magjistratit si Ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë. (3) Me *email*-in e datës 10.1.2022, subjekti i rivlerësimit, në vijim të *email*-it të parë, duke parashtruar, ndër të tjera, dhe disa problematika administrativo-ligjore, në raport me procesin e tij, ka kërkuar ndërprerjen e procesit pa vendim përfundimtar. (4) Me *email*-in e datës 12.12.2022 dhe me anë të rrugës postare, në datën 14.12.2022, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar pezullimin e procedurës së rivlerësimit kalimtar të tij deri në përfundimin e procesit gjyqësor dhe daljen e gjykatës me një vendim të formës së prerë lidhur me çështjen e pasjes ose jo nga ana e tij të statusit të Këshilltarit të Gjykatës së Lartë. (5) Subjekti i rivlerësimit, pasi me *email*-in e datës 16.1.2023, është njoftuar nga Komisioni se ky i fundit ka vendosur mospranimin e kërkesës për pezullimin e procedurës së rivlerësimit, ka paraqitur ankim ndaj vendimit të Komisionit datë ****1.2023**, protokolluar në Komision me nr. ******* prot., datë ****1.2023**. (6) Subjekti i rivlerësimit, më datë ****4.2023**, duke njohur Komisionin që, me vullnetin e tij, heq dorë nga kontrolli gjyqësor dhe administrativ mbi statusin e tij ligjor, ndër të tjera, parashtron se tashmë nuk ka asnjë motiv ligjor administrativ apo moral që ju të vazhdoni ndaj një përfaqësuesi të një organi kushtetues ...një proces të kundërligjshëm, i cili nuk duhet të kishte nisur e nuk duhet të vijojë më.

subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Balla, përpara juridiksionit gjyqësor administrativ, si dhe heqjen dorë nga kërkesa për njohjen/pasjen e statusit të Këshilltarit/Ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë paraqitur në KLGJ, depozitimi i vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ për prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe rrëzimin e padisë, si dhe ai i KLGJ-së për heqjen dorë nga kërkesa, si aktet ku subjekti i rivlerësimit bazonte kërkesën e tij për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, janë shprehje e qartë dhe e lirë e vullnetit të tij për t'iu shmangur kryerjes së procesit të rivlerësimit.

60. Komisioneri Publik nënvizon se çdo interpretim i kundërt që do të bënte të mundur, sikundër ka lejuar Komisioni në rastin konkret, ushtrimin e njërit prej funksioneve të parashikuara nga neni G i aneksit të Kushtetutës, si të ndaluara për t'u ushtruar për 15 vjet, nga një individ, që për shkak të Kushtetutës është subjekt i procesit të rivlerësimit, e që me vullnet të shfaqur qartësisht kërkon t'i shmanget këtij procesi, duke kërkuar ndërprerjen e tij, vjen në kundërshtim me qëllimin e sanksionuar në paragrafin e parë të nenit 179/b të Kushtetutës.

61. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, në analizë të rrethanave të faktit dhe kuadrit ligjor të zbatueshëm, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar të drejtat e tij, duke bërë një zgjedhje personale, duke shprehur vullnetin e pavesur për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, duke zgjedhur *ispo jure* të ketë dhe ndalimin që parashikon neni G i aneksit të Kushtetutës.

Kërkimi i ankimit

62. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e magjistratit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin;

63. Referuar nenit F dhe G, të aneksit të Kushtetutës, jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese, kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, në zbatim të nenit 66/1, germa "b", të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

Ndryshimin e vendimit nr. 675, datë 16.6.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në këtë mënyrë:

1. Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit ndaj subjektit, z. Alfred Balla.
2. Ndalimin e subjektit të rivlerësimit, z. Alfred Balla, të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshme për një periudhë 15-vjeçare.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA